



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.\_\_\_\_ Prot.

Datë 10/12/2008

**V E N D I M**

**Nr.96 datë 10 /12/ 2008**

**Për**

**Mbylljen e hetimit ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm për produktin "Karton Jeshil"**

**Komisioni i Konkurrencës**, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Z. Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Znj. Servete	GRUDA	Anëtare
Z. Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10/12/2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbylljen e hetimit ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm për produktin "Karton Jeshil".

**Baza ligjore:** Nenet 24, germa d, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

Pas shqyrtimit të raportit të Grupit të Punës "Mbi hetimin e thelluar në Tregun e Sigurimeve për produktin Karton Jeshil.

**VËREN SE:**

1. Tregu i sigurimit të detyrueshëm është treg i rregulluar dhe mbikëqyret nga Autoriteti Mbikqyrjes Financiare.
2. Në tregun e sigurimit të detyrueshëm për ofrimin shërbimit të kartonit jeshil gjatë periudhës objekt-hetimi ushtrojnë veprimtarinë e tyre 4 shoqëri sigurimesh, Sigal, Sigma, Atlantik dhe INSIG, drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë nga agentë të pavarur.
3. Nga hetimi i kryer për sa i takon ofrimin/tregtimin të produktit Karton Jeshil, rezultoi se nuk ka elementë të kufizimit të konkurrencës.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit:

**VENDOSI:**

1. Mbyllet e hetimit mbi ofrimin/tregtimin e produktit “Karton Jeshil”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Lush PERPALI**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtare**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETARE**